



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK BELSH**

Belsh më 24/ 12 / 2025

PROCES – VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 24.12.2025”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 13 këshilltarë:**

1. Kujtim Dervishi
2. Erion Gjoshi
3. Erjon Qafa
4. Avni Shtylla
5. Bujar Blloku
6. Alesander Idrizi
7. Fadil Zdrava
8. Gezim Gjoshi
9. Nexhip Elezi
10. Sami Uruçi
11. Enkeleda Kullolli
12. Aurjola Bezati
13. Ismail Paja

- Fillon mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari i këshillit. Hidhet në votim rendi ditës dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.1 e rendit të ditës .Prezanton Entela Dervishi. Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.2 për miratimin e taksave dhe tarifave. Prezanton Ditjon Pepa projekt vendimin.
- D.Pepa: Bashkia e vogël Belsh ndahet në “Qëndër” dhe “Periferi” për efekt taksash.
- Merr pjesë në mbledhje dhe Kryetari i Bashkisë Z. Arif Tafani.
- A.Tafari: Ndarja në “Qëndër” dhe “Periferi” bënë mbi bazën e ligjit?
- D.Pepa: Po, është e bazuar në ligj ndarja zonale.

- E.Gjoshi: A ka impakt ulja 30% e taksës?
- D.Pepa: Po,ka impakt në buxhet.
- I.Paja: Sa % janë mbledhur taksat?
- D.Pepa: Aktualisht janë në nivelin 70-75%.
- A.Tafari: Impakti i uljes së taksave është për të ulur shpenzimet e qytetarëve kundrejt taksave.
- S.Uruçi: A ka pasur impakt ulja e taksave?
- A.Tafari: Nuk ka impakt në nr e tatimpaguesve, por njerëzit paguajnë më pak.
- B. Blloku: Propozoj ndryshimin e pikës "I",për tarifën e pastrimit për qëndrat shëndetsore. Propozoj që tarifa për QSH të jetë zero.
- Hidhet në votim propozimi për heqjen e taksave për QSH dhe miratohet me 13 vota pro.
- Hidhet në votim p/vendimi për taksat dhe tarifat dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.3 e rendit të ditës për numrin e punonjësve.
- Prezanton Sheje Ndoni. Nuk ka ndryshim nr i punonjësve nga 2025 për 2026.
- I.Paja: Punonjësit me kontratë cilët janë?
- A.Tafari: Në rast nevojë janë 3 vënde për nëpunës me kontratë.
- I.Paja: Mendoj që Bashkisë i duhet një topograf.
- Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.4 e rendit të ditës për miratimin e nivelit të pagave.
- Prezanton Alban Nipolli p/vendimin dhe propozimin e Bashkisë për vitin 2026.
- A.Nipolli: Propozohet niveli maksimal i pagave për çdo punonjës.
- B.Blloku: Arsyja që pagat propozohen në nivel maksimal?
- A.Nipolli : Niveli i pagës është stimulues për çdo specialist dhe punonjës.
- I.Paja: A ka përpuethshmëri pozicioni i punës me arsimin përkatës?
- A.Nipolli: Ligji parashikon edhe raste kur nuk ka përpuethshmëri,por 95% e rasteve diploma është në përputhje me vëndin e punës.
- A.Tafari: Çdo këshilltar mund të shkojë ti verifikojë diplomat në zyrën e burimeve njerëzore.
- Hidhet në votim pika 4 dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.5 për shpërblimin e kryetarëve të fshatit dhe këshilltarëve për vitin 2026.
- A.Nipolli: Propozojmë 10% për këshilltarët dhe 8% për kryetarët e fshatrave.
- E.Gjoshi: A nuk duhet të kalojë bruto shpërblimi?
- A.Nipolli:Është e detyrueshme që të paguhet 15% e shpërblimit sipas legjislacionit në fuqi.
- B.Blloku: Propozoj 10% për kryepleqt.
- Nuk miratohet propozimi.
- Hidhet në votim p/vendimi dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.6 për miratimin e kuotës së këshillit të qarkut.Miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.8 e rendit të ditës. Miratohet me 13 vota pro bursat për nxënësit e arsimit profesional.
- Kalojmë te pika nr.7 e rendit të ditës për miratimin e buxhetit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.

- Prezanton A.Nipolli zë për zë.
- Kujtim Dervishi: Kemi sugjeruar buxhet për këshillin bashkiak, gjithashtu për aktivitete për barazinë gjinore.
- A.Nipolli: E kemi të pamundur të përcaktojmë vlerën për barazinë gjinore sepse nuk ka një studim tregu.
- K.Dervishi: Kush ka pyetje?
- I.Paja: Ujitja dhe kullimi, si ndahen fondet dhe si përdoren?
- A.Nipolli: Kemi 2 punonjës që paguhën nga fondet e ardhura nga Ministria e Bujqësisë.
- A.Tafari: Janë fonde që vijnë si pasojë e marrjes së kompetencave të bordit të kullimit nga ana e Bashkisë.
- I.Paja : Nuk është bërë sa duhet në rrugët e fshatrave.
- A.Tafari: Nuk është e vërtetë që nuk punohet për kanalet kulluese. Aktualisht eskavatori është në Gjolen dhe më pas do shkojë në fshatin Përroi i Zi.
- K.Dervishi: Çfarë investimesh janë parashikuar?
- A.Nipolli: Janë parashikuar rikonstruksioni i rrugëve të brëndshme, plani i mbetjeje urbane, plani për ujitje në zonën e Dumresë.
- A.Tafari: 1-Kemi sistemimin e rrugëve të brëndshme. Investimi i 2-të më i rëndësishëm është hartimi i projektit për ujitje me tubacion të mbyllur.
- Hidhet në votim p/vendimi i buxhetit dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.10 e rendit të ditës e planit të punës së këshillit bashkiak. Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.11 dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.12 dhe miratohet me 13 vota pro.
- Diskutohet pika nr.13 për miratimin e vlerës financiare për shpërblim. Miratohet me 11 vota pro dhe 2 kundër shpërblimi për rënien e zjarrit në shtëpinë e z.H.Çarçiu.
- Diskutohet pika nr.14 dhe miratohet me 12 vota pro dhe 1 kundër. Kundër I.Paja.
- Kemi një pikë shtesë për një kërkesë për shpërblim financiar për një nxënëse ekselente Enxhi Kasa që ka përfituar medaljen e artë.
- S.Uruçi: Propozoj 100.000 lekë të reja.
- K.Dervishi: Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro.

Mbyllet mbledhja me 14 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA

